



V E N D I M

K.P.P. 335/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.05.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF-54654-03-08-2018 me objekt: “*Sherbimi i ruajtjes se objekteve me roje private*”, me fond limit limit 9 000 000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.04.2018 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujësjellës Kanalizime Librazhd.”

Ankimues:

“Dea Security” sh.p.k
Rr “Ndre Mjeda”, Qendra Polifunksionale, Kati I,
Tiranë,

Autoriteti kontraktor:

Sh.a Ujësjellës Kanalizime Librazhd,
Sheshi Agjensise,
Librazhd

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.03.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr.REF-54654-03-08-2018 me objekt: “*Sherbimi i ruajtjes se objekteve me roje private*”, me fond limit limit 9 000 000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.04.2018 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujësjelles Kanalizime Librazhd.

II.2. Në datën 15.03.2018 operatori ekonomik “*Dea Security*” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke ngritur pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit të mësipërm. Konkretisht pretendohet si vijon:

“*[...] Së pari, Fondi limit i përcaktuar nga autoriteti kontraktor është i pamjaftueshëm referuar dispozitave ligjore [...] për pagën minimale, shtesat e turneve, shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.*

Së dyti, [...] përcaktimi i AKEP me zonë mbulimi Qarkun Elbasan diskriminon SHPSF që kanë AKEP me zonë mbulimi zonën ku kryhet shërbimi dhe të heqë pikën “duhet të mbulojë periudhën kohore” në të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës pasi operatorët ekonomikë mund të rinovojnë afatin e AKEP sapo të përfundojë afati ekzistues. Kërkojmë nga AK të modifikojë kriterin

për AKEP nga qark të bëhet me zonë mbulimi ku kryhet shërbimi dhe të heqë pikën “duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës”.

Së treti, [...] kërkojmë nga AK të heqë kriterin për mjek të përgjithshëm dhe deklarin e tij në tatime pasi autoriteti shprehet se për vendosjen e këtij kriteri bazohet në paragrafin 12/2 të VKM nr.692, datë 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, i ndryshuar me VKM nr.742, datë 06.11.2003”, por autoriteti duhet të heqi këtë kriter pasi dispozitat e përmendura janë shfuqizuar [...].

Së katërti, [...] kërkojmë nga autoriteti kontraktor të heqë kriterin e dhënë në pikën 9 të kërkesave për kualifikim për PMNZSH pasi është një kërkesë e ekzagjeruar, diskriminuese dhe jo në përputhje me shërbimin për të cilin kërkohet [...].

Së pesti, [...] kërkojmë të hiqet kriteri për gjenerator prej 30 KWA pasi është kërkesë e ekzagjeruar për të furnizuar një sallë operative e cila ka si pajisje një kompjuter. Dhe kërkesa për të paraqitur fatura tatimore shitje dhe/ose kontratë shitblerje dhe/ose kontratë dhurimi dhe/ose deklaratë zhdoganimi për të gjitha rastet duhet të paraqitet edhe fatura e pagesës për sendin, përjashto rastin e dhurimit, është disa herë e dubluar dhe për autoritetin duhet të jetë e mjaftueshme paraqitja e faturës tatimore. Si dhe kërkesa për UPS: faturë tatimore shitje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji dhe/ose kontratë shitblerje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji dhe/ose deklaratat e zhdoganimit e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji. Për të gjitha rastet duhet të paraqitet edhe fatura e pagesës së sendit. Për përcaktimin e kohës në faturë nuk qëndron dhe është e pabazë pasi koha përcaktohet nga pajisjet të cilat furnizohen dhe nuk maten me orë por me fuqi që harxhohet. Si dhe kërkesa që në rast se këto pajisje janë me qera, të paraqitet kontratë me noter dhe për të gjithë afatin e kryerjes së shërbimit është e ekzagjeruar dhe vetëm për të diskriminuar operatorët pjesëmarrës. Përcaktimi i një kriteri i cili nuk i referohet fare shërbimit që kërkohet të realizohet me roje fizike të cilët nuk kanë nevojë për gjenerator apo UPS si dhe komunikimi me sallën operative mund të realizohet në cdo kohë, duke përdorur mjete të tjera si radio, celular etj. Pra në asnjë rast mungesa e energjisë për sallën nuk do të pengonte shërbimin që ofrohet për autoritetin i cili kërkon prezencën e rojes fizike në objekt dhe është ai që realizon ruajtjen e objektit [...].

Së gjashti, [...] kërkojmë nga autoriteti kontraktor të heqë kërkesën për 10 jelek antiplumb pasi është në kundërshtim dhe në tejkalim me natyrën dhe përmasat e kontratës, i ekzagjeruar dhe kufizon pjesëmarrjen, pasi kërkesa për 10 jelek antiplumb nuk është vendosur tek zërat e shpenzimeve dhe nuk është shprehur as tek specifikimet teknike, pra nuk i shërben kryerjes së shërbimit [...].

Së shtati, [...] kërkojmë nga autoriteti kontraktor të heqë kërkesën për një sistem radiokomunikimi, një sistem radioalarmi, një sistem kamerash në distancë, pasi është në kundërshtim dhe në tejkalim me natyrën dhe përmasat e kontratës, i ekzagjeruar dhe kufizon pjesëmarrjen pasi kërkesa për një sistem radiokomunikimi, një sistem radioalarmi, një sistem kamerash në distancë nuk është vendosur tek zërat e shpenzimeve dhe nuk është shprehur as tek specifikimet teknike, pra nuk i shërben kryerjes së shërbimit [...].

Së teti, tek shtojca 8 pika 19 AK është shprehur për shërbimin e ruajtjes në 2 vendroje me tre turne, ndërkohë tek shtojca 9 është shprehur: shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjithë ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata (24 orë në ditë). Pra sa vendroje me shërbim 24 orë kërkohen 1 apo 2.

II.3. Në datën 17.03.2018, nëpërmjet shkresës nr. 5/27 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.4. Në datën 23.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.5. Në datën 04.04.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 579/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 5/31 prot., datë 03.04.2018, me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “[...], fondi limit i përcaktuar nga autoriteti kontraktor është i pamjaftueshëm referuar dispozitave ligjore [...] për pagën minimale, shtesat e turneve, shpenzimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Njoftimin e kontratës, Seksioni 2 “Objekti i kontratës”, pika 2.8 “Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër”, dhe 2.9 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin» të dokumentave të tenderit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor, thuhet:

Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. *Fondi limit 9 000 000 leke pa tvsh*
2. *Burimi i Financimit Te ardhurat e veta*
4. *Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër **Sherbimi i ruajtjes se objekteve me roje private***

*Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për 1 vendroje me tre turne është **4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore).***

*Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për 1 vendroje me dy turne është **3.32 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore)** **Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane percaktuar me afat 12 mujor***

2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

*Kohëzgjatja në **muaj 12 ose ditë** ☐ ☐ ☐ ☐*

III.1.2. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, pjesë e dokumentave të tenderit të publikuara në datën 09.03.2018 nga autoriteti kontraktor, është parashikuar:

1. *1.[...] Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore etj, per sherbimin e ruajtjes ne 2 vend roje me tre turne.*
2. *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.*

Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertes të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje me 2 turne (3.32 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.

Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Preventiv të koston për 1 roje në ditë për 1 vendroje me shërbim 3 Turne me shërbim 24 orësh

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /ditë	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /ditë
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Shpenzime për nderlidhje (bazuar në tarifat vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin dhe kostove për blerje radio dhe pajisjeve të qendres së kontrollit)		
6	Shpenzime për kapacitete të tjera mbështetëse (shpenzime transporti për punonjes, pajisje të tjera mbështetëse dhe trajnime)		
7	Shpenzime Administrative		
8	Fitimi i shoqërisë		
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në ditë		
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në ditë		

Preventiv të koston për 1 roje në ditë për 1 vendroje me shërbim 2 Turne (Turni II+III) shërbim 16 orësh

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /ditë	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /ditë
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Shpenzime për nderlidhje (bazuar në tarifat vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin dhe kostove për blerje radio dhe pajisjeve të qendres së kontrollit)		
6	Shpenzime për kapacitete të tjera mbështetëse (shpenzime transporti për punonjes, pajisje të tjera mbështetëse dhe trajnime)		
7	Shpenzime Administrative		
8	Fitimi i shoqërisë		
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në ditë		
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në ditë		

- Operatores janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për 1 vendroje me tre turne është **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**).
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për 1 vendroje me dy turne është **3.32** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**).

SHËNIM: Operatorët ekonomikë krahas Formularit të Ofertës dhe preventivit të publikuar në dst duhet të paraqes edhe:

-Analizën e Çmimit me përlllogaritje konkrete aritmetike, në të cilën të jenë përfshirë të gjitha detyrimet ligjore si:

- Shpenzime për pagë bazë,
- Shtesë mbi pagë për turnin II,
- Shtesë mbi pagë për turnin III,
- Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%,
- shpenzime për nderlidhje,
- kosto për kapacitete të tjera mbështetëse,
- shpenzime administrative,
- fitimi i shoqërisë.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomikë ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizës së kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë operatorëve ekonomikë sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjerisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, autoriteti do ta skualifikojë.

- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.1.3. Në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në datën 01.03.2018, është parashikuar:

Specifikimet teknike

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Shërbimi në 3 vendroje në hyrjen kryesore me dy turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.

Kërkesat për zbatimin e shërbimit

Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit Nr.75/2014, datë 10.07.2014 "Për SHPSF"

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

Rojet e turnit të tretë të jenë të pajisur me armë

Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.

d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.

e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.

III.1.4. Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” është përcaktuar se vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë:

Shërbimi që kërkohet:

Marreveshje kuader ku të gjitha kushtet janë përcaktuar - me afat 12 muaj.

Shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Shërbimi në 3 vendroje në hyrjen kryesore me dy turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë)

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj që nga data e lidhjes së marreveshjes kuader

Ndërsa në termat e referencës është parashikuar:

Marreveshje kuader ku të gjitha kushtet janë përcaktuar - me afat 12 muaj. Kontrata do të lidhet sipas afateve të përcaktuara nga AK

Shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Shërbimi në 3 vendroje në hyrjen kryesore me dy turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë)

III.1.5 Në VKM-në Nr. 399, datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” ku shprehimisht përcaktohet: “[...] Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale, orare, të jetë 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë.[...]”

III.1.6. Në Ligjin Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: “Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

III.1.7. Referuar “Kodit të Punës” e më konkretisht: “Neni 81 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Shtesa mbi pagë ” 8 “Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtese

mbi pagë jo më pak se 20% dhe çdo orë pune e kryer midis intervalit 22.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50%”,

Neni 82 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Koha javore e punës”

Me kohëzgjatje javore të punës kuptohet koha e punës e kryer nga e hëna në mëngjes ora 0 deri të dielën e ardhshme ora 2400. Në nenin 83 të “Kodit të Punës”, është parashikuar: « Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës”.

Neni 85 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Pushimi javor”

1) Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje.

2) Pushimi javor përfshin ditën e diel.

3) Pushimi javor nuk është i pagueshëm.

4) Përjashtimet rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 86 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Ditët e festave zyrtare”

1) Si rregull ndalohet puna në ditët e festave zyrtare.

2) Punëmarrësi gëzon të drejtën e pagës në ditët e festave zyrtare.

Kur dita e festës zyrtare bie në ditët e pushimit javor, pushimi shtyhet ditën e hënë.

3) Përjashtimet për të punuar në ditët e festave zyrtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose në kontratën kolektive.

Në nenin 87, po kët, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25% ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj.”;

Neni 92 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Pushimet vjetore/Kohëzgjatja”

1) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohen me kontratën kolektive ose me kontratën individuale të punës.

2) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim.

3) Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës. Periudhat e paaftësisë së përkohshme në punë, konsiderohen si kohë pune.

III.1.8. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

III.1.9. Në nenin 59, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht:

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativavetë renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga 9 institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

- çmimet e tregut;ose/dhe

- çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

- çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet."

III.1.10. Në Rekomandimin e APP-së dhe KPP-së të datës 20.12.2017, protokolluar nga APP-ja me nr. 15/66 prot., datë 20.12.2017, dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me nr. 1858 prot., datë 20.12.2017, në pikën 1 të tij parashikohet shprehimisht se: "[...]Për shërbimin 24 orë pa ndërprerje (nga e hëna në të dielë), numri i rojeve për vendroje duhet të llogaritet me koeficientin e zëvendësimit 1.66 punojës për turn".

III.1.11. KPP sqaron se Autoriteti Kontraktor, në përputhje me dispozitat e ligjit për prokurimin publik dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, hartimin dhe miratimin e buxhetit, mirëpërdorimin e fondeve dhe menaxhimin e procedurave të prokurimit publik, përgjegjës direkt për përlllogaritjen e fondit limit dhe argumentimin e tij.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nisur nga kërkesat e parashikuara në shtojcën 9 "Specifikimet teknike", shtojcën 10 "Termet e referencës" dhe shtojcën 11 "Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit" të publikuar nga autoriteti kontraktor në SPE ku kërkohet që shërbimit i ruajtjes me roje të realizohet në dy vendroje me dy turne (turni II dhe turni III) dhe një vendroje me tre turne, që do të kryejnë shërbimin për 12 muaj pa ndërprerje, si dhe referuar bazës ligjore si më sipër cituar, nga përlllogartitjet e kryera rezulton se fondi limit nuk mjafton për realizimin me sukses të shërbimit të kërkuar, duke përbërë shkak për anulimin e prcedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë pretendimi i ankimesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se: " , [...] përcaktimi i AKEP me zonë mbulimi Qarkun Elbasan diskriminon SHPSF që kanë AKEP me zonë mbulimi zonën ku kryhet shërbimi dhe të heqë pikën "duhet të mbulojë periudhën kohore" në të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës pasi operatorët ekonomikë mund të rinovojnë afatin e AKEP sapo të përfundojë afati ekzistues. Kërkojmë nga AK të modifikojë kriterin për AKEP nga qark të bëhet me zonë mbulimi ku kryhet shërbimi dhe të heqë pikën "duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikaur të kryhet zbatimi i kontratës".

III.6.1. Në shtojcën 8, nëndarja "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 2, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

"Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" me zone mbulimi Qarkun Elbasan. Periudha e vlefshmërisë së Licencës/Autorizimit duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës. Operatorët ekonomik te paraqes xhirimin bankar shlyerjen e pageses ndaj AKEP per vitin 2018."

III.2.2. Ndërsa në shtojcën 12 “*Termet e referencës*” është përcaktuar se vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë:

« Vendi i kryerjes së shërbimeve: 1. Depo Qarrishte, 2. Depo Librazhd, 3. Depo Prrenjas. »

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

III.2.4. Në pikën 2, të nenit 28 “*Kontratat e shërbimeve*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, është parashikuar se: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

III.2.5. Në nenin 66, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “*AKEP-i lëshon një autorizim individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me PKRF-në dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas neneve 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të këtij ligji.*” Në këto autorizime, përcaktohet edhe zona e mbulimit (neni 70, pika 1, e Ligjit të lartpërmendur), ku përcaktohet se “*Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave përmban: a) të dhëna për përfituesin; b) frekuencat e përfituara; c) vendndodhjen dhe zonën e mbulimit; ç) afatin e vlefshmërisë së autorizimit; d) kushtet, që duhet të përmbushen për shfrytëzimin e frekuencës së caktuar, sipas nenit 71 të këtij ligji.*”

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimin me sukses të kontratës.

Referuar Shtojcës 12 ku përcaktohet vendndodhja e objektit të prokurimit, që është i shtrirë në tre objekte në Depo Qarrishte, 2. Depo Librazhd, 3. Depo Prrenjas të cilat përfshihen në Qarkun e Elbasanit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri për paraqitjen e autorizimit të lëshuar nga AKEP, referuar objektit të prokurimit, nuk duhet të kërkohej detyrimisht vetëm për Qarkun Elbasan, por duke lejuar alternativën në përputhje “me vendet ku do të kryhet shërbimi”. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërcituar, duke lejuar përveç përcaktimit për Qarkun e Elbasanit edhe mundësinë e paraqitjes së autorizimit individual për qytetin/qytetet ku përfshihet vendndodhja e objektit/objekteve në ruajtje.

Përsa i përket kërkesës që *periudha e vlefshmërisë së Licencës/Autorizimit duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në datën e hapjes së ofertave, Autorizimi Individual i subjektit ofertues duhet të jetë i vlefshëm. Fakti që afati i vlefshmërisë së autorizimit përfundon gjatë kohës së zbatimit të kontratës, nuk duhet të penalizojë subjektin, duke i kufizuar atij të drejtën për të marrë pjesë dhe rrjedhimisht për t'u kualifikuar në procedurën e prokurimit. Operatorët ekonomike kanë të drejtë të rinovojnë licensat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në asnjë rast autoriteti kontraktor nuk mund të përcaktojë një kriter të tillë i cili skualifikon pa të drejtë shoqëritë të cilave u përfundon afati i autorizimit gjatë kohës së zbatimit të kontratës. Zgjatja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual apo rinovimi i saj bëhet konform *ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"* dhe *akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij*. Është detyrim ligjor i autoritetit kontraktor të kërkojë, gjatë periudhës së realizimit të kontratës, zbatimin e detyrimeve nga ana e operatorit ekonomik me të cilin është lidhur kontrata, sic përcaktohen në dokumentat e tenderit dhe në kontratë.

Në bazë të nenit 62 "*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*" të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit dhe angazhimet e ofruara do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe angazhimet e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: "*[...] kërkojmë nga AK të heqë kriterin për mjek të përgjithshëm dhe deklarin e tij në tatime pasi autoriteti shprehet se për vendosjen e këtij kriteri bazohet në paragrafin 12/2 të VKM nr.692, datë 13.12.2001 "Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", i ndryshuar me VKM nr.742, datë 06.11.2003", por autoriteti duhet të heqi këtë kriter pasi dispozitat e përmendura janë shfuqizuar [...]*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 "*Kriteret e vecanta të kualifikimit*", "*Kapaciteti teknik*", pika 8, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kushtit të mëposhtëm:

"Operatori ekonomik ofertues duhet që në stafin e tij të ketë edhe 1 Mjek të përgjithshëm.

Per të përmbushur këtë, operatori ekonomik duhet të paraqes Diplom, Kontrat Pune, Licence për ushtrimin individual të profesionit për mjek të leshuar nga Urdheri i Mjekeve të Shqipërisë dhe deklarin në Tatime.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, kriteri duhet të përmbushet nga secili operator ekonomik në të kundërt përben kusht për skualifikim."

III.3.2. Në nenin 46, të LPP-së parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.3.3. Në nenin 28, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.3.4. Në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, çdo punëdhënës, për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen e punëmarrësve për të gjitha çështjet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë:

- a) ngarkon një ose disa punëmarrës, si persona përgjegjës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion;
- b) u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke vendosur marrëdhënie kontraktuale me ta.

Kapitulli II “Klasifikimi i punëdhënësve në grupe, për efekt të organizimit të punëmarrësve në shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin”, përcakton se:

“1. Për efekt të organizimit të shërbimit të brendshëm për mbrojtjen dhe parandalimin, punëdhënësit janë klasifikuar në katër grupe, si më poshtë vijon:

1.1 Grupi A përfshin punëdhënësit me më shumë se 1000 (një mijë) punëmarrës. Ky numër punëmarrësish reduktohet në:

1.1.1 500 (pesëqind) punëmarrës për ndërmarrjet e:

- a) industrisë së pastrimit dhe shpërndarjes së ujit;
- b) industrisë së transformimit të metaleve, mekanikës e precizionit dhe industrisë optike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë e referuara në nënndarjen 1.1.2, shkronjat “dh”, “e”, “ë” e “f”;
- c) industritë e tjera prodhuese, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industritë referuara në pikën 1.1.2, shkronja “g”.

1.1.2 250 (dyqind e pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet e:

- a) industrisë së prodhimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit, avullit dhe ujit të ngrohtë;
- b) industrisë së prodhimit dhe të përpunimit fillestar të metaleve;
- c) prodhimit industrial prej guri, çimentos, betonit, qeramikës, qelqit dhe të tjerët;
- ç) industrisë kimike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë e referuara në 1.1.3, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”;
- d) prodhimit industrial të fibrave artificiale dhe sintetike;
- dh) industrisë së fabrikimit të veprave në metale;
- e) industrisë së ndërtimit të makinerive dhe të pajisjeve mekanike;
- ë) industrisë së ndërtimit dhe të autopjesëve;
- f) industrisë së ndërtimit të pajisjeve të tjera të transportit;
- g) industrisë së drurit dhe mobilieve të drurit;
- gj) industrisë së ndërtimit dhe të punëve publike.

1.1.3. 50 (pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet:

- a) e industrisë bërthamore;
- b) me furrat koks;
- c) e përpunimit të naftës;
- ç) e industrisë së prodhimit të kimikateve bazë;
- d) e industrisë petro-kimike dhe karbokitike;
- dh) e industrisë së prodhimit të produkteve të tjera kimike, kryesisht për industri dhe bujqësi.

1.2 Grupi B përfshin punëdhënësit me punëmarrës:

- a) nga 251 deri në 1000 persona, të cilët nuk janë përfshirë në grupin A;
- b) nga 100 deri në 250 persona, të cilët nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.1 të këtij kreu;
- c) nga 50 deri në 200 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.2 të këtij kreu;
- ç) nga 20 deri në 50 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.3 të këtij kreu.

1.3 Grupi C përfshin punëdhënësit me më pak se 200 (dyqind) punëmarrës, të cilët nuk përfshihen në grupet A dhe B.

1.4 Grupi D përfshin punëdhënësit që punësojnë më pak se 20 (njëzet) punëmarrës”.

Për punëdhënësit, që përfshihen në grupet A, B dhe C, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në pikat 10 e 11 të kreut III të këtij vendimi kryhen gjithmonë nga personat e ngarkuar përgjegjës për çështjet e sigurisë e të shëndetit në punë.

3. Vetëm në rastet kur kapacitetet dhe burimet e ndërmarrjes/institucionit janë të pamjaftueshme për ta përmbushur këtë shërbim, ato bashkëpunojnë me persona apo shërbime të jashtme të specializuara për zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese.

4. Për punëdhënësit e grupit D, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në pikat 10 e 11 të kreut III të këtij vendimi, kryhen gjithmonë nga persona apo shërbime të specializuara jashtë ndërmarrjes, të kontraktuara nga punëdhënësi.

III.3.5. Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat

dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma” b “ dhe pika 4 gërma “b” është përcaktuar:

1. "Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: "6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë." [...]

2. Në kreun IV, pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon: "7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili:

b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune;

b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit".

4/b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi".

III.3.6. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit, rezulton se, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që shoqëria të ketë në stafin e tij mjekun e përgjithshëm, i cili është një përcaktim detyrues referuar VKM nr. 742, datë 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë".

Lidhur me sa më sipër Komisioni sqaron se, në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi".

Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 *“Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”*.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me mjekun qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit sipas së cilës: *“[...] kërkojmë nga autoriteti kontraktor të heqë kriterin e dhënë në pikën 9 të kërkesave për kualifikim për PMNZSH pasi është një kërkesë e ekzagjeruar, diskriminuese dhe jo në përputhje me shërbimin për të cilin kërkohet [...]*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti teknik”*, pika 9, rezulton se autoriteti kontraktor ka parashikuar plotësimin e kërkesës si më poshtë vijon:

“Me qellim parandalimin e zjarreve dhe trajnimin e punonjesve të shërbimit, për shkak se:

-Ka rrezikshmëri të shtuar ndaj zjarrit si rezultat i pranisë të lëndëve djegëse dhe gazeve, motogjenerator, lëndë të djegshme (karburante), etj, operatori ekonomik ofertues duhet që në stafin e tij të ketë 1 Ekspert privat Zjarrefikes në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 2 të nenit 34 të ligjit nr.8766, datë 05.04.2001 ”Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”.

Per te permbushur kete, operatori ekonomik duhet te paraqes Licence kodi I.2A te leshuar nga QKL ose QBK, Kontrat Pune, deklarimin ne Tatime, Leje per ushtrimin e profesionit leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme/Drejtoria e PMNZSH.

Per operatorete ekonomik qe nuk kane ne staf Ekspertin, duhet te paraqesin:

- *Kontrate shërbimi nënshkruar me Ekspertin të licencuar për këtë lloj shërbimi;*
- *Licence kodi I.2A të leshuar nga QKL ose QBK,*
- *Leje për ushtrimin e profesionit leshuar nga Ministria e Puneve të Brendeshme/Drejtoria e PMNZSH*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, kriteri duhet të përmbushet nga secili prej operatoreve ekonomik në të kundërt përben kusht për skualifikim.”

III.4.2. Në nenin 38 të Ligjit Nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”* parashikohet se: *“Personat fizikë e juridikë detyrohen të: a) zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe aktet e tjera nënligjore për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin; b) marrin masa për parandalimin e pakësimit në zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre”*.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të*

nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm nuk është proporcional objektin e prokurimit. Roli i subjekteve juridikë privatë, parashikuar edhe nga lex specialis “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, është i kufizuar në marrjen e masave parandaluese dhe njoftimin e organeve të specializuara në rast të rënies së zjarrit. Kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor është një kriter i ekzagjeruar dhe që nuk përputhet me natyrën e kontratës objekt prokurimi, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumentave të tenderit, duke e hequr këtë kusht kualifikues.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “[...] kërkojmë të hiqet kriteri për gjenerator prej 30 KWA pasi është kërkesë e ekzagjeruar për të furnizuar një sallë operative e cila ka si pajisje një kompjuter. Dhe kërkesa për të paraqitur fatura tatimore shitje dhe/ose kontratë shitblerje dhe/ose kontratë dhurimi dhe/ose deklarata zhdoganimi për të gjitha rastet duhet të paraqitet edhe fatura e pagesës për sendin, përjashtoj rastin e dhurimit, është disa herë e dubluar dhe për autoritetin duhet të jetë e mjaftueshme paraqitja e faturës tatimore. Si dhe kërkesa për UPS: faturë tatimore shitje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji dhe/ose kontratë shitblerje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji dhe/ose deklaratat e zhdoganimit e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të furnizimit me energji. Për të gjitha rastet duhet të paraqitet edhe fatura e pagesës së sendit. Për përcaktimin e kohës në faturë nuk qëndron dhe është e pabazë pasi koha përcaktohet nga pajisjet të cilat furnizohen dhe nuk maten me orë por me fuqi që harxhohet. Si dhe kërkesa që në rast se këto pajisje janë me qera, të paraqitet kontratë me noter dhe për të gjithë afatin e kryerjes së shërbimit është e ekzagjeruar dhe vetëm për të diskriminuar operatorët pjesëmarrës. Përcaktimi i një kriteri i cili nuk i referohet fare shërbimit që kërkohet të realizohet me roje fizike të cilët nuk kanë nevojë për gjenerator apo UPS si dhe komunikimi me sallën operative mund të realizohet në cdo kohë, duke përdorur mjete të tjera si radio, celular etj. Pra në asnjë rast mungesa e energjisë për sallën nuk do të pengonte shërbimin që ofrohet për autoritetin i cili kërkon prezencën e rojes fizike në objekt dhe është ai që realizon ruajtjen e objektit [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 10, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si vijon:

4. “Me qellim funksionimi i Salles Operative 24 ore ne 24 ore pa nderprerje, operatori ekonomik duhet të disponoje minimalisht 1 gjenerator rezerve me jo me pak se 30 KËA, me qellim funizimin e salles me energji ne rast nderprerje te saj.

Ne rastet kur gjeneratori eshte ne pronesi, operatori duhet te paraqes:

- *Fatura Tatimore Shitje dhe/ose*
- *Kontrate Shitblerje dhe/ose*
- *Kontrate Dhurimi dhe/ose*
- *Deklarat Zhdoganimi per te gjitha rastet duhet te paraqitet edhe fatura e pageses per sendin perjashtoj rastin e dhurimit.*

Ne rastet kur pajisja nuk eshte ne pronesi, te paraqitet:

- Kontrata e lidhur përpara Noterit për marrjen në përdorim të sendit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës
- Faturën tatimore të shitblerjes së sendit dhe/ose
- Deklaratën e zhdoganimit

Autoriteti rezervon të drejtën e verifikimit të salles dhe në rast se kostat se operatori ekonomik nuk disponon realisht kapacitetin, autoriteti përveç se do ta skualifikoje do ta denoncoje edhe në APP për qellim të Nenit 13 të LPP-se.

Për operatorët ekonomik që nuk disponojnë gjenerator, duhet të paraqesin Bateri dhe/ose UPS që garantojnë funizimin me energji të Qendrës së Kontrollit për jo më pak se 10 orë në përputhje me nenin 22 të ligjit Nr.75/2014. **Për të përmbushur këtë kriter, operatorët duhet të paraqesin:**

Në rastet kur pajisja është në pronësi, operatori duhet të paraqesë:

- Fatura Tatimore Shitje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji dhe/ose
 - Kontratë Shitblerje e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji dhe/ose
 - Deklaratë Zhdoganimi e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji
- Për të gjitha rastet duhet të paraqitet edhe fatura e pagesës për sendin.

Në rastet kur pajisja nuk është në pronësi, të paraqitet:

- Kontrata e lidhur përpara Noterit për marrjen në përdorim të sendit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji.
- Faturën tatimore të shitblerjes së sendit e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji dhe/ose
- Deklaratën e zhdoganimit e cila të ketë të specifikuar kohën minimale të funizimit me energji.

Autoriteti rezervon të drejtën e verifikimit të salles dhe në rast se kostat se operatori ekonomik nuk disponon realisht kapacitetin, autoriteti përveç se do ta skualifikoje do ta denoncoje edhe në APP për qellim të Nenit 13 të LPP-se.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, kriteri duhet të përmbushet nga secili prej operatoreve ekonomik në të kundërt përben kusht për skualifikim.”

III.5.2. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.5.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të vërtetojë se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të realizojë kontratën objekt i këtij prokurimi. Në këtë aspekt, Komisioni vëren se autoriteti kontraktor ka parashikuar, përveç sallës operative edhe disponimin e gjeneratorit dhe mjeteve të tjera alternative për subjektet të cilat nuk disponojnë gjenerator për këtë procedurë prokurimi (bateri, ups), disponimi

i të cilave, pra kapaciteteve teknike dhe konkretisht bateri dhe ups, të vërtetohet vetëm nëpërmjet dokumentave të mëposhtme: - kontratë shitblerje dhe/ose faturë tatimore shitje, dhe/ose kontratë qiraje të noterizuar, dhe/ose kontratë dhurimi dhe/ose deklaratë zhdoganimit ku tek të gjitha të jetë e specifikuar koha minimale e furnizimit me energji.

Komisioni gjykon se dokumentacioni i mësipërm i kërkuar nga autoriteti kontraktor është i ekzagjeruar dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit si edhe me dispozitat e ligjit për prokurimin publik. Sqarojmë se komunikimi i punonjësve të shërbimit me sallën operative mund të bëhet në cdo kohë, duke përdorur mjete të tilla si radio, celular etj.

Për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatori ekonomik të vërtetojë se gëzon kapacitetet e nevojshme për realizimin e shërbimit dhe nuk mund të përcaktojë kritere në tejkalim të natyrës dhe objektit të prokurimit, pra për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që të vërtetojë që operatorët ekonomikë gëzojnë kapacitete në lidhje me sallën operative dhe nuk mund të vendosë kushte edhe për mënyrën se si do të funksionojë kjo sallë, fakt ky që është në përgjegjësi të operatorit ekonomik.

Operatorët ekonomikë deklarojnë përmbushjen e specifikimeve teknike me shtojcën përkatëse të përcaktuar në dokumentat e tenderit, duke përfshirë këtu edhe deklarin për përmbushjen e specifikimeve teknike në lidhje me kryerjen e shërbimit, ku përfshihet edhe salla operative. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rast të mosfunksionimit të sallës operative, autoriteti kontraktor në bazë të nenit 62 të LPP, si organi kompetent për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, ka të drejtë të prishë kontratën nëse do të ketë shmangie nga kushtet apo detyrimet e kontratës nga ana e operatorit ekonomik.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përcaktimi i kriterit të mësipërm është diskriminues dhe si i tillë duhet hequr.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “[...] kërkojmë nga autoriteti kontraktor të heqë kërkesën për 10 jelek antiplumb pasi është në kundërshtim dhe në tejkalim me natyrën dhe përmasat e kontratës, i ekzagjeruar dhe kufizon pjesëmarrjen, pasi kërkesa për 10 jelek antiplumb nuk është vendosur tek zërat e shpenzimeve dhe nuk është shprehur as tek specifikimet teknike, pra nuk i shërben kryerjes së shërbimit [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 14 e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga autoriteti kontraktor është kërkuar që operatorët ekonomikë të plotësojnë kushtin e mëposhtëm:

”Me qellim ruajtjen e jetes se punonjesve te sherbimit, grupeve te gatshem nga veprimet kriminale te personave qe hyjne apo dalin nga Institucioni, Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon minimalisht 10 Jelek Antiplum.

Ne rastet kur pajisjet jane blere brenda vendit operatori duhet te paraqese:

- a) Fatura Tatimore e Shitjes e firmosur nga te dyja palet dhe e vulosur nga shitesi;*
- b) Pagesen qe verteton vleren e blerjes se dedektoreve;*
- c) Deklarimin e fatures tatimore te shitjes ne sistemin elektronik te tatimeve;*

Per rastet kur keto kapacitet jane blere jashte vendit, operatori duhet te paraqes:

- a) Deklaraten e Zhdoganimit nepermjet se ciles vertetohet zhdoganimi i dedektoreve;
 - b) Xhirimin Bankar qe verteton pagesen e vleres se blerjes se dedektoreve;
 - c) Deklarimin e fatures tatimore te shitjes ne sistemin elektronik te tatimeve;
- Autoriteti rezervon te drejten e verifikimit te pajisjeve dhe ne rast se kostaton se operatori ekonomik nuk disponon realisht pajisjet, autoriteti pervec se do ta skualifikoje do ta denoncoje edhe ne APP per qellim te Nenit 13 te LPP-se.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, kriteri duhet te permbushet nga secili prej operatoreve ekonomik ne te kundert perben kusht per skualifikim.”

III.6.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit, është kërkuar si vijon:

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Shërbimi në 3 vendroje në hyrjen kryesore me dy turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë)

III.6.3. Neni 37 i Ligjit 75/2014 parashikon shprehimisht se:

- Subjekti i SHPSF-së, për realizimin e detyrës, vë në dispozicion të punonjësve të shërbimit mjete e pajisje shërbimi. 2. Lloji i mjeteve e pajisjeve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

III.6.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.6.5. Në Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të ndryshuar , neni 23, pika 1 dhe 2, përcaktohet se: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”.

III.6.6. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 1, 2 dhe 5, parashikon se: “1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe

të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose 9 b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.6.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: “2. Qëllimi i këtij ligji është: 10 a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Lidhur me kërkesën e ankimuesit “Dea Security” shpk për heqjen e kërkesës për 10 jelek antiplumb, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përderisa kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, kushti i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me numrin e kërkuar për jelekët antipumb e tejkalon numrin e punonjësve të shërbimit të cilët do ti përdorin këto pajisje, sipas numrit të vendrojeve.

Për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriteret në fjalë duke ulur kërkesën për jelek antiplumb, në përputhje me përmasat e kontratës dhe konkretisht në raport të drejtë me kërkesën për vendroje ku do të kryhet shërbimi, si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Punëve të

Brendshme nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, duke nxitur pjesëmarrjen e oferuesve në procedurën e prokurimit, sic parashikohet në nenin 1 të LPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Dea Security” shpk qëndrojnë pjesërisht.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “[...] kërkojmë nga autoriteti kontraktor të heqë kërkesën për një sistem radiokomunikimi, një sistem radioalarmi, një sistem kamerash në distancë, pasi është në kundërshtim dhe në tejkalim me natyrën dhe përmasat e kontratës, i ekzagjeruar dhe kufizon pjesëmarrjen pasi kërkesa për një sistem radiokomunikimi, një sistem radioalarmi, një sistem kamerash në distancë nuk është vendosur tek zërat e shpenzimeve dhe nuk është shprehur as tek specifikimet teknike, pra nuk i shërben kryerjes së shërbimit [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Lidhur me kërkesën e ankimuesit për heqjen e kriterit për një sistem radiokomunikimi, në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 16, rezulton se është kërkuar si vijon:

16. Operatori duhet të disponojë jo më pak se 1 Sistem Radiokomunikimi të vertetuar me fatura tatimore, pagesat perkatese dhe deklarimin e faturave ne sistemin elektronik te tatimeve.

III.7.1.1. Në shtojcën 8, nëndarja “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zone mbulimi Qarkun Elbasan. Periudha e vlefshmërisë së Licencës/Autorizimit duhet të mbulojë periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryhet zbatimi i kontratës. Operatorët ekonomik të paraqes xhirimin bankar shlyerjen e pageses ndaj AKEP per vitin 2018.”

III.7.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është përshkruar kryerja e shërbimit si vijon:

“Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Shërbimi në 3 vendroje në hyrjen kryesore me dy turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.

Kërkesat për zbatimin e shërbimit

Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit Nr.75/2014, date 10.07.2014 “Për SHPSF”

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre

Rojt duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

Rojet e turnit të tretë të jenë të pajisur me armë

Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.

d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energji elektrike.

e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt. “

III.7.1.2. Neni 37 i Ligjit 75/2014 parashikon shprehimisht se:

- Subjekti i SHPSF-së, për realizimin e detyrës, vë në dispozicion të punonjësve të shërbimit mjete e pajisje shërbimi. 2. Lloji i mjeteve e pajisjeve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

III.7.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.7.1.4. Neni 28, pika 5, gërma “ç” e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: _dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.7.1.5. Në nenin 1 “Objekti dhe Qëllimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.7.1.6. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.*

III.7.1.7. Në nenin 23 pika 1, 2, “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*
2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

III.7.1.8. Në nenin 28, pika 1 “Kontratat e shërbimeve” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet”.

III.7.1.9. Referuar kriterëve të sipërcituara si dhe pretendimeve të ankimuesit Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar në pikën 16 të kapacitetit teknik për jo më pak se një sistem radiokomunikimi është një kërkesë e përsëritur dhe e panevojshme, pasi autoriteti kontraktor ka parashikuar shprehimisht në pikën 2 të kapacitetit teknik, kërkesën për licencë /autorizim për ngritje dhe shfrytëzim të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP çka përmbush më së miri qëllimin e autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë të jenë të pajisur me radiokomunikim dhe radioalarm. Dorëzimi i licencës së lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nga ana e operatorëve ekonomikë dëshmon më së miri se këta të fundit plotësojnë kapacitetet teknike lidhur me pajisjet e radiokomunikimit dhe radioalarmit. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kriterit të përcaktuar në pikën 16 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.7.2. Lidhur me kërkesën e ankimuesit për heqjen e kritereve një sistem radioalarmi, një sistem kamerash në distancë, pasi është në kundërshtim dhe në tejkalim me natyrën dhe përmasat e kontratës, i ekzagjeruar dhe kufizon pjesëmarrjen pasi kërkesa për një sistem radiokomunikimi, një sistem radioalarmi, një sistem kamerash në distancë nuk është vendosur tek zërat e shpenzimeve dhe nuk është shprehur as tek specifikimet teknike, pra nuk i shërben kryerjes së shërbimit, në shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pikat 17 dhe 18 rezulton se është kërkuar si vijon:

17. Operatori duhet të disponojë jo më pak se 1 Sistem Radioalarmi të vertetuar me fatura tatimore, pagesat perkatese dhe deklarimin e faturave në sistemin elektronik të tatimeve.

18. Operatori duhet të disponojë jo më pak se 1 Sistem Kamerash në distancë të vertetuar me fatura tatimore, pagesat perkatese dhe deklarimin e faturave në sistemin elektronik të tatimeve.

III.7.2.1. Në shtojcën 9 "Specifikimet teknike" të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është përshkruar kryerja e shërbimit si vijon:

"Të dhëna për shërbimin e kërkuar"

Shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Shërbimi në 3 vendroje në hyrjen kryesore me dy turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.

Kërkesat për zbatimin e shërbimit

Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit Nr.75/2014, datë 10.07.2014 "Për SHPSF"

Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

Rojet e turnit të tretë të jenë të pajisur me armë

Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.

d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.

e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt."

III.7.2.2. Neni 37 i Ligjit 75/2014 parashikon shprehimisht se:

- Subjekti i SHPSF-së, për realizimin e detyrës, vë në dispozicion të punonjësve të shërbimit mjete e pajisje shërbimi. 2. Lloji i mjeteve e pajisjeve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

III.7.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.7.2.4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe 5, parashikon:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, nëpërputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtëme aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë përpërmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.7.2.5. Në nenin 1 “Objekti dhe Qëllimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.
2. Qëllimi i këtij ligji është:
 - a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
 - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.7.2.6. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

III.7.2.7. Në nenin 23 pika 1, 2, “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*
2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

III.7.2.8. Në nenin 28, pika 1 “Kontratat e shërbimeve” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet”.

III.7.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Referuar rregullave të prokurimit publik si më sipër cituar, natyra e shërbimit duhet të shprehet qartë në termat e referencës dhe specifikimet teknike, të cilat duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Për autoritetin kontraktor është konsideruar e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron *1 sistem radioalarmi dhe një sistem kamerash në distancë*, por nga shqyrtimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës të hartuara nga ky autoritet, nuk rezulton të jetë dhënë ndonjë informacion lidhur me përdorimin e sinjaleve të alarmit dhe sistemit të kamerave në distancë për shërbimin e kërkuar.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *”tek shtojca 8 pika 19 AK është shprehur për shërbimin e ruajtjes në 2 vendroje me tre turne, ndërkohë tek shtojca 9 është shprehur: shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjithë ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata (24 orë në ditë). Pra sa vendroje me shërbim 24 orë kërkohen 1 apo 2”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 19 e dokumentave të mësipërme të prokurimit, publikuar në SPE në datën 09.03.2018, rezulton se është kërkuar si më poshtë:

*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **Preventivin e meposhtem:***

Sqarime:

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore etj, per sherbimin e ruajtjes ne 2 vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.
Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 2 turne (3.32 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.
Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.
Preventiv te kostos per 1 roje ne dite per 1 vendroje me sherbim 3 Turne me sherbim 24 oresh

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Shpenzime per nderlidhje (bazuar ne tarifat vjetore te Akep per Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin dhe kostove per blerje radio dhe pajisjeve te qendres se kontrollit)		
6	Shpenzime per kapacitete te tjera mbeshetese (shpenzime transporti per punonjes, pajisje te tjera mbeshetese dhe trajnime)		
7	Shpenzime Administrative		
8	Fitimi i shoqerise		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

Preventiv te kostos per 1 roje ne dite per 1 vendroje me sherbim 2 Turne
(Turni II+III) sherbim 16 oresh

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Shpenzime per nderlidhje (bazuar ne tarifat vjetore te Akep per Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin dhe kostove per blerje radio dhe pajisjeve te qendres se kontrollit)		
6	Shpenzime per kapacitete te tjera mbeshetese (shpenzime transporti per punonjes, pajisje te tjera mbeshetese dhe trajnime)		
7	Shpenzime Administrative		

8	Fitimi i shoqërisë		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 3.5.2017,” Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për 1 vendroje me tre turne është **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**).
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për 1 vendroje me dy turne është **3.32** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**).

SHËNIM: Operatorët ekonomikë krahas Formularit të Ofertës dhe preventivit te publikuar ne dst duhet te paraqes edhe:

-Analizën e Çmimit me përllogaritje konkrete aritmetike, në të cilën të jenë përfshirë të gjitha detyrimet ligjore si:

- Shpenzime për pagë bazë,
- Shtesë mbi pagë për turnin II,
- Shtesë mbi pagë për turnin III,
- Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%,
- shpenzime per nderlidhje,
- kosto për kapacitete të tjera mbështetëse,
- shpenzime administrative,
- fitimi i shoqërisë.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizes se kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka te drejte tu kerkoje operatoreve ekonomik sqarime ne lidhje me zerat e ofertes ekonomike dhe ne rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjerisht dhe me dokumentacion mbeshtetes oferten, autoriteti do ta skualifikoje.

- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

III.8.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” është përshkruar shërbimi si më poshtë:

“Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Shërbimi në 1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

Shërbimi në 3 vendroje në hyrjen kryesore me dy turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë) [...]”

III.8.3. Në datën 21.03.2018, nëpërmjet një shtojce të publikuar në SPE, autoriteti kontraktor ka sqaruar dhe ka modifikuar dokumentat e tenderit, lidhur me kërkesën e mësipërme, si vijon:

“Per te gjithë operoret e interesuar

Autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Librazhd, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar), V.K.M nr.914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ju bën me dije se ka bere modifikimin e DST, kriterëve kualifikuese, si dhe shtyrjen e dates se pranimit dhe hapjes se ofertave të përcaktuara në DT , të publikuara në [ëëë.app.gov.al](http://eëë.app.gov.al).

ISHTE

1. Te sqaroje per DST operatorët ekonomike si me poshte:

- **Ne lidhje me kriterin 2.3 pika 19 e kapacitetit teknik**
Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për 1 vendroje me tre turne është **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**).
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për 1 vendroje me dy turne është **3.32** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**).

sqarojme se:

BEHET

Në pikën 2.3 pika 19 e kapaciteti teknik

Ju sqarojme se shërbimi per procedurën e prokurimit publik do te jete :

- Shërbimi në **1 vendroje në hyrjen kryesore me tre turne** në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)
- Shërbimi në **3 vendroje në hyrjen kryesore me dy turne** në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë). ”

III.8.3. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimin e ankimuesit dhe ka sqaruar operatorët ekonomikë lidhur me numrin e vendrojeve me tre turne dhe dy turne, duke modifikuar dokumentat e tenderit lidhur me pikën 19 të kapacitetit teknik si dhe duke përputhur të dhënat e parashikuara në shojcën 9 “Specifikimet teknike” me ato të shtojcës 8 si më sipër cituar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF-54654-03-08-2018 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes së objekteve me roje private”, me fond limit limit 9 000 000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 09.04.2018 nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit.

3. Me rishpalljen e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik dhe me legjislacionin përkatës në fuqi..
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 579 Protokolli,
Datë 23.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

